



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 26.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **25.04.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **MET BAT Sh.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Asgjësimi i barnave me afat te skaduar neper Njësitë Shëndetësore te Burgjeve”** me Nr. të Prok: **206-23-2160-221** nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **MET BAT Sh.P.K** dt. 25.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Asgjësimi i barnave me afat te skaduar neper Njësitë Shëndetësore te Burgjeve”** me Nr. të Prok: **206-23-2160-221** nxjerr., kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 20.04. 2023 te publikuar ne platformën elektronike.
2. **Vërtetohet** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 20.04.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik **MET BAT Sh.P.K** me datë 25.04.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Asgjësimi i barnave me afat te skaduar neper Njësitë Shëndetësore të Burgjeve”** me Nr. të Prok: **206-23-2160-221**. Autoriteti Kontraktues, me datë 26.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas **MET BAT Sh.P.K:**

Neni 1 – Qellimi

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 – Barazia ne trajtim / jo-Diskriminim



Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve  
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës  
Neni 64 –Dëshmitë e kërkesave  
Neni 69 –Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

### Pretendimi ankimor

Të nderuar ne me dt. 20.04.2023 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë PRINCI COMPANY SH.P.K, ndërsa ne jemi eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Oferta e OE MetBat SH.P.K- është e papërgjegjshme në kërkesat formale/administrative, sepse tek Pjesa I. Formulari i Tenderit ka ofruar çmimin në total 2.40 € ndërsa te totali në përshkrim të çmimit e ka ofruar çmimin 9,600.00 €.

Rregulloreja nr. 001/2022 për Prokurimin Publik konkretisht nenin 40.10. pika (b) përcakton se në rast të tilla oferta duhet të refuzohet citoj:

40.10 Tenderuesi do të informohet me shkrim menjëherë për korrigjime të tilla. Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga AK në këtë mënyrë:

- a. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet;
- b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

Ju sqarojmë se arsyeja e juaj për eliminimin tonë është e pa bazuar, për faktin se ne kemi ofertuar me çmim për njësi, përkatësisht tek përshkrimi i çmimeve shihet qartë se tek rubrika “Çmimi për njësi me TVSH”, ne kemi ofertuar me çmim prej 2.40 €.

Tek rubrika sasia për tri vite është vendosur 4000 (njësia matëse kg).

Kur shumëzohet çmimi për njësi me TVSH me sasinë e përafërt atëherë totali del të jetë 9,600.00€, pra në këtë rast nuk ka mospërputhje të çmimeve siç keni pretenduar ju.

Ne e kemi vendosur çmimin total në vlerën 9,600.00 €, për sasinë e përafërt të cilën ju e keni përcaktuar, mirëpo sasia e përafërt për tri vite mund të jetë më e madhe apo më e vogël se sa që ju e keni përcaktuar, andaj kuptohet qartë se në këtë rast vlen çmimi për njësi me të cilin ne kemi ofertuar dhe se kontrata duhet të nënshkruhet me çmimin për njësi, pasi që sasinë janë vetëm sasi indikative.

Tek aneksi 1 i dosjes së tenderit tek specifikimet teknike të detyrueshme është specifikuar saktë “Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është [+/-30%]”. Nga ky fakt kuptohet se është dashur të ofertohet me çmim njësi dhe kontrata në këtë rast nënshkruhet për çmim njësi dhe jo çmim total, andaj në këtë rast vërtetohet fakti se nuk ekziston asnjë mospërputhje e çmimeve dhe se nuk ka asnjë gabim aritmetik.

Nëse nënshkruhet kontrata me çmimin total të sasive indikative dhe nëse nuk shpenzohen të gjitha sasinë indikative por shpenzohen 70 % të tyre, atëherë AK-ja detyrohet të paguaj të gjithë çmimin e sasive indikative dhe me këtë rast dëmtohet buxheti i autoritetit kontraktues. Apo nëse shpenzohen 30 % më shumë të sasisë indikative atëherë çmimi total ndryshon dhe rezulton se paguhet më shumë se sa çmimi i dhënë i sasisë indikative, pra kemi ndryshim të çmimit të nënshkruar me çmimin final.

Tek kontratat kornizë, ku lejohet +- 30%, nënshkrimi i kontratës bëhet duke u bazuar në çmimin për njësi, e edhe në këtë tender nënshkrimi i kontratës duhet të bëhet me çmim për njësi.

Në këtë rast është dashur të keni parasysh çmimin për njësi me të cilin ne kemi ofertuar, sepse në këtë rast çmimi për njësi i vendosur nga ana jonë në vlerë prej 2.40 €, mbizotëron dhe i njëjti është dashur të merret parasysh si çmimi bazë dhe se me këtë çmim duhet të nënshkruhet kontrata, prandaj nga këto fakte kuptohet që nuk ka asnjë mospërputhje të çmimeve të ofruara nga ana jonë.

Gjithashtu fakti se çmimi mbizotëruar në tenderin e një OE është çmimi për njësi, vërtetohet edhe tek neni 28.3 i dosjes së tenderit ku është e cekur shumë qartë se “Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotëruar mbi çdo çmim tjetër kontraktor”. Pra edhe tek dosja e tenderit është paraparë qartë se çmimi për njësi është çmim mbizotëruar,



mirëpo që ju nuk e keni marr parasysh fare as këtë fakt, duke e shfaqur edhe një herë diskriminimin që po i bëni kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit. Pra nga faktet e lartcekura kuptohet qartë se ne kemi ofertuar me çmim për njësi me 2.40 €, mirëpo që për çudi ju nuk e keni marr fare parasysh këtë fakt edhe pse çmimi i tillë figuron tek përshkrimi i çmimeve

Po ashtu edhe tek Rregullorja nr.001/2022 përkatësisht tek neni 54.10 është përcaktuar qartë se *“Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të*

*specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar”.*

Nga sqarimet e lartcekura, kuptohet qartë se neni 40.10 pika b e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik nuk përkon me këtë rast sepse në këtë rast nuk ka mospërputhje të çmimit total tek formulari i tenderit dhe tek përshkrimi i çmimeve sepse çmimi për njësi është i njëjti edhe tek formulari i tenderit e edhe tek përshkrimi i çmimit. Rubrika e çmimit për sasinë e përafërta është përcaktuar nga ana juaj, mirëpo ky çmim nuk mund të shënohet në formular të tenderit sepse çmimi i formularit të tenderit duhet të jetë edhe çmimi kontraktues me rastin e nënshkrimit të kontratës, kurse në këtë rast nëse vendoset në kontratë çmimi i sasive të përafërta dhe nëse realizohet minus 30% apo plus 30% atëherë ndryshon çmimi kontraktues. \_\_\_\_\_  
Në lidhje me arsyen e dytë të eliminimit tonë, ju e keni cekur se:

Po ashtu oferta MetBat SH.P.K. është e papërgjegjshme, meqenëse nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 4 lidhur me përshtatshmërinë profesionale, konkretisht nuk e ka ofruar Licencën e kërkuar, por ka ofruar një leje mjedisore e cila nuk e plotësor kërkesën e tenderit.

Sikurse arsyeja e parë për eliminim, edhe arsyeja se kinse nuk e kemi ofruar licencën e kërkuar është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme, për më tepër është arsye tendencioze dhe njëkohësisht diskriminuese ndaj kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm dhe më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Ju sqarojmë se duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-060 për mbeturina në nenin 55 paragrafi 2 shkruan decidivisht, citojmë *“Licenca për menaxhimin e mbeturinave nuk do të lëshohet për operatorët që operojnë në objektet dhe impiantet, të cilat janë të detyruar të i nënshtrohen procedurës për marrjen e lejes integruar mjedisore sipas Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes”.*

Nga kjo dispozitë kuptohet qartë që Ministria nuk lëshon licencë për operatorë të cilët janë të detyruar ti nënshtrohen procedurës për marrjen e lejes së integruar mjedis sipas Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.

Prandaj në këtë rast rezulton se kërkesa e dosjes së tenderit është përmbushur nga kompania jonë dhe e rëndësishme është se ne si kompani kemi të drejtë të bëjmë asgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme dhe nuk është më rëndësi emërtimi i dokumentit që e posedon kompania, Licencë apo leje e integruar mjedisore, sepse ligji i lartpërmendur neni 55 paragrafi 2 po e cek shumë qartë që *“Licenca për menaxhimin e mbeturinave nuk do të lëshohet për operatorët që operojnë në objektet dhe impiantet, të cilat janë të detyruar të i nënshtrohen procedurës për marrjen e lejes integruar mjedisore sipas Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes”.*

Nga këto sqarime kuptohet qartë, që kompanive të cilat e posedojnë lejen mjedisore nuk ju lëshohet licencë, prandaj edhe neve nuk na është lëshuar licenca, por çka është më rëndësi është fakti se ne si kompani që kemi leje mjedisore të integruar kemi të drejtë të bëjmë asgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme dhe me këtë rast nuk mund të konsiderohemi të papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit sepse Licenca e kërkuar është e mbuluar me Lejen mjedisore të integruar dhe në këtë rast duhet të llogaritet e barasvlershme me licencën.

Ne në një rast më herët kishim kërkuar sqarime vetë nga MMPHI dhe kishim marr përgjigje si në vijim:



9/1/22, 3:53 PM

Gmail - Sqarim



Nardi Kadriu <nardimetbat@gmail.com>

### Sqarim

3 messages

Nardi Kadriu <nardimetbat@gmail.com>  
To: perparim.terziu@rks-gov.net

1 July 2022 at 11:48

Pershendetje z.Terziu, shpresoj te jeni mire dhe punet po ju shkojn mbar!

Une jam Nardi Kadriu perfaqesues i kompanis MetBat sh.p.k

MetBat sh.p.k posedon Leje te Inegruar Mjedisore me nr reference 822 / DMMU 6594/17 ne te cilen shkruan qarte se cilat aktivite kemi te drejt ti kryejm.

Ne te gjithë tenderet ne te cilet po aplikojm po na kerkojn shpjegime shites lidhur me lejen pasi qe po kerkojn (licens veqmas per asgjesimin e barnave dhe produkteve medicinale).

Te lutem nese mundesh nje shkres nga ju ku ceken kjar se cilat aktivite kemi te drejt ti kryejm sepse ne secilin tender po e kemi te njetin problem.

Faliminderit ne mirekuptim,

Nardi Kadriu  
044 124280

Adem Tusha <Adem.Tusha@rks-gov.net>  
To: "nardimetbat@gmail.com" <nardimetbat@gmail.com>  
Cc: Ismail Hetemaj <Ismail.Hetemaj@rks-gov.net>, Visare Hoxha <Visare.Hoxha@rks-gov.net>, Perparim Terziu <Perparim.Terziu@rks-gov.net>

4 July 2022 at 13:54

I nderuar,

Kompania "MetBat" SHPK impianti për asgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme posedon Lejen Mjedisore te Integruar prej 06.02.2019-18.07.2027 dhe ka te drejte te bëj asgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme.

Sipas nenit 55, paragrafi 2, Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Licenca për menaxhimin e mbeturinave nuk do të lëshohet për operatorët që operojnë në objektet dhe impiantet, të cilat janë të detyruar të i nënshtrohen procedurës për miratim dhe lejes integruar mjedisore sipas Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndodjes.

### Sqarim

Licenca për menaxhimin e mbeturinave te kompania ne fjale është e mbuluar me Lejen Mjedisore të Integruar.

<https://mail.google.com/mail/u/0/?ik=4855067145&view=pt&search=all&permthid=thread-a%3A1-13292391457382400504:simpl=msg-a%3A1-5156211852278021166&simpl=msg-f%3A17374230082537...> 1/2

9/1/22, 3:53 PM

Gmail - Sqarim

Me respekt

Adem TUSHA

Zyrtar i lartë për Leje Mjedisore të Integruar

From: Perparim Terziu  
Sent: 01 July 2022 15:14  
To: Adem Tusha <Adem.Tusha@rks-gov.net>  
Subject: FW: Sqarim

[Quoted text hidden]

Nardi Kadriu <nardimetbat@gmail.com>  
To: prokunimi.he@gmail.com

5 July 2022 at 10:22

Konfirmimi nga Ministria e Ambientit  
[Quoted text hidden]

Edhe ju, nëse keni dilema në lidhje me lejen mjedisore dhe të drejtën tonë përasgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme, lirisht drejtojuni MMPHI dhe merrni përgjigje zyrtare nga ky institucion.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se ne kemi OE i përgjegjshëm dhe meçmim më të lirë në këtëaktivitet të prokurimit, andaj nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemime arsyetime të tilla siç i keni dhënë ju.

Ne kemi ofertuar meçmim për njësi 2.40 €, kurseOE i rekomanduar për kontratëme çmim prej 2.70 €apo për sasi të indikative 10,800 €.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekënmë lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhekrahassimi i tenderëve nuk është bërë në harmonime nenin 59 tëLPP-së dhenjëkohësisht nukështë respektuar edhekriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi ipërgjegjshëmmeçmimmë të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 tëLPP-së, sepse na keni diskriminuar neveduke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimitpër kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 tëLPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do titrajoj operatorët ekonomik nëmënyrë të barabartëdhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë nëmënyrë transparente”*. Në këtë rast nuk është respektuaras neni 6 ekonomiciteti sepse është eliminua pa bazë ligjoreoferta meçmim të ulët, kurse në këtë rast dëmtohet buxheti i shtetit.

Ju si AK duhet të keninë konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoritetevekontraktuese nëKosovë.

Duke u bazuar në tëgjitha dëshmitë dhe faktet qëu përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që tëmerrni:

#### **VENDIM**

**APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE“MetBat” SH.P.K

**ANULOHET**, njoftimi mbi vendimineAK-së(B58)dhe lënda kthehet në**RISHQYRTIM**dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhetnë harmoni me kërkesate dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave tëLPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktettona, ne kemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

#### **Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore**

Ne lidhje me dispozitat e shkelura te LPP-se për te cilat pretendon **"MET BAT Sh.P.K"**, Autoriteti Kontraktues hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

1. Neni 1 (Qëllimi) – sipas këtij neni AK është i obliguar qe të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Edhe pse nuk keni dhënë asnjë argument se si është shkelur kjo dispozite, AK ju njofton se ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK duke shfrytëzuar procedurën e hapur me qëllim te sigurimit ne mënyrën me efikase me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit et fondeve publike.



2. Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) - sipas këtij neni AK është i obliguar që të sigurojë që fondet publike dhe burimet publike përdoren në mënyrën më ekonomike, gjë të cilën AK e ka respektuar, duke shpallur **fitues ofertën e Përgjegjshme me çmimin me te ulet.**
  
3. Neni 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) - sipas këtij neni AK është i obliguar që do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese, gjë të cilën AK e ka respektuar, sepse ka shpallur **fitues ofertën e Përgjegjshme me çmimin me te ulet, ndërsa oferta e juaj nuk ka plotësuar kushtet administrative ne përputhje me Rregulloren e prokurimit publik, te aprovuar nga KRPP.**
  
4. Neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) – ky nen përcakton që Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Oferta e juaj nuk është plotësuar ne përputhje me Rregulloren 001/2022 e aprovuar nga KRPP, përkatësisht neni 40.10 i cili përcakton:  
 40.10 Tenderuesi do të informohet me shkrim menjëherë për korrigjime të tilla. Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga AK në këtë mënyrë:
  - a. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet;
  - b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

**Oferta e juaj ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, prandaj edhe është refuzuar.**

5. Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës – përcakton që Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; Pretendimi i juaj se ekzaminimi vlerësim dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 60.1.1 nuk qëndron sepse oferta e juaj nuk është oferte e përgjegjshme.
  
6. Neni 64 –Dëshmitë e kërkesave - përcakton se një kandidat ose tenderues do të dëshmojë me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; (ii) të verifikojë përshtatshmërinë e tij profesionale, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji; (iii) i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të këtij ligji . **Ju nuk keni dhene asnje argument se si eshte shkelur ky Nen.**
  
7. Neni 69 –Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale – përcakton kërkesat dhe dëshmitë të cilat i përcakton AK dhe duhet dorëzuar nga OE. Edhe pse ju nuk keni dhene asnje argument se si eshte shkelur ky Nen, nese e keni fjalën per Licence ju infomrojme se vendimi i MSh eshte marr ne perputhje me vendimin e OSHP me numer 281/22 te dates 16.08.2022. Sidoqofte edhe pse keni bashkangjitur konfirmimet nga MMPHI , te datës korrik 2022, te cilat janë konfirmime para datës se vendimit te OSHP-se, ju infomrojme se ju jeni eliminuar adminsitrativisht dmth Cmimi i dhene ne Listen e Cmimeve NUK përkon me Cmimin total te dhene nga ju ne Formularin e Tenderit. Dhe edhe njëherë përsërisim se




kjo mosperputhe nuk lejoet me neni 40.10 te Rregullores se prokurimti publik te aprovuar nga KRPP.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit